



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 18.09.2019
Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7874, DATË
17.11.1994, “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 18.09.2019 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për një shtesë në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi së bashku me stafin mbështetës.

Relatore për shqyrtimin e projektligjit u caktua Znj.Antoneta Dhima.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, është organizatë patriotike, atdhetare, vullnetare e veteranëve të luftës për liri, pavarësi kombëtare e të drejta demokratike. Ajo ka për qëllim të ruajë e të zhvillojë traditat patriotike të popullit shqiptar dhe t'ua trashëgojë brezave pasardhës. Ajo zhvillon veprimtari në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal dhe organizatat jo qeveritare. Punon për përjetësimin e tërënëve në luftën për liri e pavarësi të atdheut.

Projektligji ka si qëllim të bëjë një shtesë në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994, “*Për statusit e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*”, të ndryshuar, duke përcaktuar ditën e përkujtimit dhe të nderimit të veteranit të LANÇ-it për përkushtimin, sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë.

Në këtë datë përkujtimore, organizata e veteraneve, shoqëria civile, institucionet shtetërore, qendrore e vendore dhe organet e pushtetit vendor organizojnë aktivitete të ndryshme për nder të veteranëve të LANÇ-it, të cilët kanë spikatur me përkushtimin, angazhimin dhe sakrificën e tyre në LANÇ dhe ndërtimin e vendit pas lufte.

Nëpërmjet projektligjit synohet të vlerësohet në vazhdim sakrifica dhe kontributi i veteranëve në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë.

Veteranët e luftimeve çlirimtare, janë të respektuar në gjithë botën. Le t'i nderojmë dhe ne njerëz të tillë, tanimë dhe në ditën e 20 korrikut që propozohet me ligj, si Dita e Veteranit, datë kjo që përkon edhe me datën e krijimit (20.07.1957) të Organizatës së Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

- **Përfundim**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare, duke vlerësuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

Relator

Antoneta DHIMA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ